



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.239/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Vedat Peterqoi – Kryetar, znj. Kimete Gashi – Referuese, znj. Nita Bejta -Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Bajra N.P.T.”–Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje bujqësore”, me nr. të prok: 632-22-5204-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjakovë”, më datën: 22.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APPROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Bajra N.P.T.”–Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje bujqësore”, me nr. të prok: 632-22-5204-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjakovë”.

II. ANULOHET, njoftimi për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje bujqësore”, me nr. të prok: 632-22-5204-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK- “KK-Gjakovë”, dhe obligohet autoriteti kontaktues që të bëjë korrigjimet e dosjes së tenderit konform nenit 53 parag. 7 të këtij ligji , dhe të shtyjë afatin për ofertim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “Bajra N.P.T.”–Prishtinë, i aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues: “Bajra N.P.T.”–Prishtinë, që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues: “Bajra N.P.T.”–Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 29.06.2021 me nr. 239/22, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje bujqësore”, me nr. të prok: 632-22-5204-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- “KK-Gjakovë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 6 , 7 , 28 , 68 , 69 , të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 20 të RRUOPP-së .

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.07.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 22.07.2022, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: “Bajra N.P.T.”–Prishtinë,

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Eksperti teknik sqaron se Rreth pretendimit/kerkesës nr.1 AK duhet që të lejojë pjesëmarrje për OE të cilët ofrojnë edhe numrin minimal të thikave (20), pasi që është kufizim i tepërt dhe mendojmë që edhe me 20 thika mund të kryhet puna në menyrë të duhur (Mund të vlerësohet më shumë më pastaj numri më i lartë i thikave, mirëpo mund të mirret parasyshtë edhe aspekti i çmimit në këtë kontekst). Pasi që është pohimi që është problem të gjendet motokultivator me numrin e kërkuar të thikave. Rreth pretendimeve të palëve rreth numrit të thikave dhe punës së motorit, qëndron fakti që çdo element shtesë i cili instalohet në makinën punuese, kërkon fuqi me të madhe dhe e rëndon punën e motorit (Mirëpo në këtë kontekst, duhet që OE që sjellë pajisjen me numër me të lartë të thikave duhet që të sjellë edhe deshmi që pajisja është kompatible me makinën punuese, pra që nuk e veshtirëson punën e makinës).Në këtë rast, nga aspekti teknik mund të favorizohet ai me shumë thika pasi që qëndron pohimi që më shumë thika arrijnë që të bluajnë tokën me mirë.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Eksperti teknik sqaron se Tek kërkesa e dytë në lidhje me boshtin shtytës të cilin AK e ka kërkuar 30FI , vlerësojmë që edhe këtu duhet që të caktohet një minimum në mënyrë që të shmangim përshtatjen për një prodhues të caktuar të moto kultivatorëve apo OE. Për këtë pikë, AK duhet që të caktoj një minimum me të ulët sesa ai i përcaktuar në paramasë, mirëpo kjo të mos ndikoj në kualitetin e përgjithshëm të pajisjeve dhe të punëve të cilat duhet të kryhen me anë të këtyre pajisjeve. E konsideroj të padrejtë, favorizimin e parametrave teknik të një prodhuesi (LABIN), në raport me prodhuesit tjerë në kriteret fillestare të tenderit. Pasi që gjatë hulumtimeve kemi vërejtur që parametrat teknik të një Moto kultivatori të quajtur (Special Green) përputhen në masë të madhe me parametrat minimal të kërkuara nga AK.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Eksperti shqyrtues sqaron se sa i përket kërkesave për ISO standarde, kërkesa për ISO 9001 nuk ka të bëjë me cilësinë e produkteve, andaj nëse qëllimi i AK-së të sigurohet se produktet janë cilësore ISO 9001 nuk jep asnjë garanci në këtë drejtim dhe si e tillë është panevojshme. Kërkesa për ISO 14001:2015 lidhur me menaxhimin e mjedisit, vlerësojmë se kjo kërkesë duhet drejtuar/kërkuar nga prodhuesi i pajisjeve jo nga OE ofertues, pasi rreziku për ndotje të mjedisit etj. mund të vij pikërisht nga prodhuesit e pajisjeve.

Kërkesa për ISO 45001:2018 lidhur me shëndetin dhe sigurinë në pinë, vlerësojmë se në rast se në Republikën e Kosovës ka ndonjë Ligji i Punës siç pretendon OE ankues i obligon kompanitë të kenë raportin e vlerësimit të riskut, i cili raport trajton menaxhimin e riskut dhe shëndetit në punë, atëherë vlerësojmë se një raport i tillë duhet të pranohet nga AK si ekuivalent me kërkesën për ISO 45001:2018.

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Eksperti teknik sqaron se Sa i përket kërkesës me nr. 4. Vlerësohet si e drejtë kërkesa e OE që të përcaktohen minimumet dhe maksimumet e karakteristikave teknike të pajisjeve të cekura, me qëllim që pjesëmarrja në tender të jetë për një numër me të lartë të OE, të cilët mund të ofrojnë zgjedhje me të shumta për AK nga aspekti teknik. Pas kësaj, AK mund të vlerësoj duke u bazuar në karakteristikat teknike dhe në raport me çmimin të përzgjedhë atë OE i cili është më i përshtatshëm nga të dyja aspektet. Ky raport nuk konsiston në përshtatjen e kërkesave të paramasës për OE ankues, mirëpo ka për qëllim që nga aspekti teknik të ju mundësohet më shumë OE të ofertojnë, në mënyrë që AK të bëj zgjedhjen me të mirë nga aspekti teknik- eksplotues si dhe nga aspekti ekonomik.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovet pjesërisht si e bazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që të bëhen korrigjimet e dosjes së tenderit sipas rekomandimeve në këtë raport, si dhe të shtyhet afati për ofertim në pajtim me dispozitat e LPP-së nenit 53 par.7 të këtij ligji.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 22.07.2022, me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik: “Bajra N.P.T.”–Prishtinë, me datë: 22.07.2022, me anë të parashtrësës , ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 18.08.2022, me praninë e palëve në procedurë ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me objektin e shqyrtimit si dhe me shkresat e lëndës dhe në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së se ankuese “ NPT BAJRA” z. Fetoshi i cili deklaroi: ne qëndrojmë ne tersi pran pretendimeve tona ankimore te parashtruara ne ankesën e datës 29.06.2022

Ne vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit te AK-së z. Gutaj i cili deklaroi: Ne si AK nuk mendojmë se ju ka përgatit një OE te caktuar nuk mendoj qe ka kufizime . te pika një te thikat nuk e thotë strikt 24 por 24 e përpjete ndër 24 nuk bën te jetë kështu ka menduar edhe njësia kërkuese. AK qëndron pas vendimit te marr mendon qe është i drejt transparent nëse PSH mendon se duhet te ndryshohet atëherë është gjithmonë i gatshëm qe ti pranoj.

Ne vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z. Halili i cili deklaroi: qëndroj mbrapa ekspertizës

Eksperti teknik z. Berisha deklaroj : Sa i përket pretendimeve të OE qëndron që nr. i thikave është pra i njëjti me specifikat teknike të prodhuesit Labin kjo për pretendimin nr. 2. Te pretendimi nr. 2 të bosht shtytës që e ka kërkuar AK me një vlerë të caktuar edhe këtu është mundshme të caktohen vlerat minimale në mënyrë që t'ju mundësohet OE të ofertoj me karakteristika të ndryshme teknike. Gjatë hulumtimeve edhe këtu është konstatuar që i përshtaten të njëjtit prodhues Labin.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron:

Lidhur për të gjitha pretendimet e ankimore të OE ankues se autoriteti kontraktues në Dosjen e Tenderit ka favorizuar prodhues të caktuar, paneli shqyrtues në tërësi mbështetet në raportin e përpiluar nga të dy ekspertët e caktuar nga OSHP (ekspert teknik dhe ekspert profesional), detyrë e të cilëve ka qenë që të shqyrtohen të gjitha pretendimet ankimore dhe mendimi i tyre profesional me gjithë plotësimin e ekspertizës së tyre që e bënë në seancën e mbajtur, është se kërkesa nr. 1 dhe 2 ju kanë përshtatur prodhueseve të caktuar dhe si të tilla paraqesin diskriminim. Ndërsa, kërkesa 3 dhe 4, të bëhen përmirësimet konform vlerësimit të ekspertëve shqyrtues, të bëra në raportin e ekspertizës së tyre. Kështu që, edhe arsyetimet e dhëna nga ekspertët shqyrtues llogariten si arsyetime të panelit shqyrtues.

Paneli shqyrtues konstaton se autoriteti kontraktues në këtë rast sa i përket kërkesave të vendosura në Dosje të Tenderit që ndërlidhen me pretendimeve ankimore, janë në kundërshtime me nenin 7 të LPP-së, *Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi*. Andaj, AK duhet të bëjë përmirësimet e dosjes së tenderit dhe të shtyjë afatin për ofertim konform nenit 53.7 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – “KK- Gjakovë”,
- 1x1 OE - “Bajra N.P.T.”–Prishtinë,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

